

UNITED NATIONS

United Nations Interim
Administration Mission
Kosovo



UNMIK

ATIONS UNIES

ission
Administration
térinaire des Nations
ies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligjislatura e dytë

*Komisioni për Shëndetësi, Punë
dhe Mirëqenie Sociale*
Nr. 24/2007

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më 11. 9. 2007, në sallën N-225, në orën 13.00

Të pranishëm: Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, kryetare: Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Flora Brovina, Teuta Hadri, Zylfije Hundozi, Rudina Bukoshi, Fehmi Vula, Nurishahe Hulaj dhe Ferid Agani, anëtarë.

Munguan: Naim Jerliu dhe Zllatica Kujunxhiq.

Moren pjesë:

Flora Sylejmani-Krifca - NDI

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

REND DITE

- 1 Marrja e qëndrimit të Komisionit lidhur me procedim të mëtutjeshëm pas dëgjimit të**
- 2 Shqyrtimi i Projekt udhëzimit administrativ për themelimin, përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm Profesional**
- 3 Shqyrtimi i Projektligjit për lirinë dhe të drejtat e organizimin sindikal**
- 4 Të ndryshme**

Rendi i ditës u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e parë

1. Marrja e qëndrimit të Komisionit lidhur me procedim të mëtutjeshëm pas dëgjimit të përfaqësuesit të Fondit Monetar Ndërkombëtar

Fatmire Mulhaxha –Kollçaku, pasi e përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera ceku: Ju e dini se çka u theksua nga përfaqësuesi i Fondit Monetar Ndërkombëtar lidhur me implikimet buxhetore. Pra, sipas metodologjisë çdo projektligji duhet t'i ketë vlerësimet financiare. Në vlerësimet e MPMS dhe Ministrisë së Financave vërehen dallime, njëra Ministri deklaroi se kosto financiare kap shumen prej 13 milion euro, kurse tjetra 23 milion euro. Projektligjit të punës megjithatë i mungon koncepti, ngase nuk janë dhënë shpjegime për fushat që rregullon. Po ashtu, përmban të meta, që nga dispozitat e nenit 1. Këto të mangësi që ka projektligji është dashur t'i shqyrtojë Qeveria para se të arrijë në Kuvend. Prandaj lidhur me këtë pikë ftoi të pranishmit që ta marrin fjalën.

Ilaz Pireva ishte i mendimit se më parë duhet të shikohet se a figuron në kornizën afatmesme të Qeverisë së Kosovës e pastaj të kërkohet miratimi në Kuvendin e Kosovës. Ai lidhur me këtë theksoi se kjo që ka ndodhur do të ishte një përvojë për deputet e legjislaturën e ardhshme që ndërlidhet me projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për Inspektoratin e punës.

Nafije Berisha vuri në pah - Projektligji i punës nuk ka hyrë në strategjinë afatmesme, por sipas saj Qeveria ka mundësi brenda vitit ta rishikojë. Ajo, propozoi që lidhur me këtë të ftohen ministrat e dy Ministrive: Ministrisë së Punës dhe asaj për Ekonomi dhe Financa dhe të bisedohet për modalitet në mënyrë që mos të kthehet projektligji.

Fehmi Vula u pajtua me propozimin e parafolëseve dhe shtoi: Ministrat do të jepnin udhëzime lidhur me zvogëlimin e kostos buxhetore. Prandaj, theksoi se shteti harton ligje për popull e jo për vete. Ai kërkoi që të mos të shqyrtohen projektligjet sekondare pa u shqyrtua Projektligji i punës.

Flora Brovina tha nuk ka shtet pa ligje. Ajo kërkoi që mos të përsëritet praktika si kurse me Ligjin për veteranet e luftës. Sipas saj projektligji i punës të parcializohet duke iu shkëput disa pjesë, në mënyrë që mos të ketë implikime buxhetore. Ajo që thuhet se zbatimin e këtij ligji i dëmtojnë interesat e investitorëve nuk qëndron. Prandaj ky Komision do të duhet të i mbrojë interesat e punëtorëve.

Teuta Hadri kërkoi të respektohet përfundimi i Komisionit që u nxor më parë që të mos procedohet me ligje të tjera deri sa mos të shqyrtohet me Projektligji i punës.

Zylfije Hundozi u pajtua me parafolësit dhe shtoi -Nga ajo që u dëgjua dje nga përfaqësuesi i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Projektligji i punës mund t'i kthehet Qeverisë së Kosovës dhe shtoi se në mund të miratojmë këtë por PSSP- nuk e shpall. Ajo tha se seancën plenare kam kërkuar nga ministri deklaratën financiare lidhur me koston buxhetore të P/gjit të punës.

Ilaz Pireva serish mori fjalën dhe kërkoi shpjegim nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me hartimin e projektligjeve

Ferid Agani ishte i mendimit se Komisioni duhet të mbajë takim me Komisionin për buxhet ku do të ftoheshin dy ministrat dhe t'ia prezantojmë atyre problemet.

Nurishahe Hulaj lidhur me procedimin e Projektligjit kërkoi të mirët pragu kalues dhe në bazë të tij të behet amendamenti. Gjithashtu, propozoi me rastin e rishqyrtimit të ftohet kryeministri.

Komision pas një debati të gjerë dhe konstruktiv lidhur me këtë pikë nxori :

Përfundim

Të ftohet ministri i Punës dhe Mirëqenie Sociale z. Ibrahim Selmanaj dhe ai për Ekonomi dhe Financa z. Haki Shatri, në mbledhjen e datës 18.9.2007, Komisioni do të marrë qëndrimi lidhur me procedimin e mëtejme të Projektligjit të punës dhe ligjeve te tjera të kësaj fushe .

U hap shqyrtimi për piken e tretë

2 Shqyrtimi i Projekt udhëzimit administrativ për themelimin, përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm Profesional

Ferid Agani si raportues ne përgatitjen nënvizoi Duke e vlerësuar përpjekjen e Ministrisë për përmbushjen e kësaj dispozite të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës Komisioni ka përfunduar, si vijon: (1) Projekt udhëzimet administrative nuk sigurojnë rolin dhe përgjegjësinë adekuate të punëtorëve shëndetësorë të Kosovës dhe të asociacioneve të tyre profesionale, në procesin e themelimit, organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Përgjithshëm Profesional, (2) Siç është propozuar, Këshilli i Përgjithshëm Profesional do të jetë një strukturë burokratike – administrative e Ministrisë së Shëndetësisë, me kompetenca të paqarta këshillëdhënëse dhe ekzekutive.

Komisioni vlerëson se është e domosdoshme, që në mënyrë të ngutshme të përpilohet versioni i ri i këtij akti nën-ligjor, në pajtim me standardet ndërkombëtare në këtë lëmi dhe rrethanat specifike të Kosovës

Komisioni u pajtua që ne forme te sugjerimit t'i dërgohet Ministrisë se Shëndetësie

U hap shqyrtimi për piken e katërt

3 Shqyrtimi i Projektligjit për lirin dhe organizimin sindikal

Komisioni u që kjo pik e rendit të ditës te mos shqyrtohet deri sa të arrij përgjigja nga takim që do të me mbahet në ndërmjet dy ministri

U hap shqyrtimi për piken e katërt.

4. Të ndryshme

U diskutua lidhur me caktimin e terminit për mbajtjen e dëgjimit publik për Projektligjin për përkrahje financiare të familjeve të personave me aftësi të kufizuara.

Mbledhja përfundoi në orën 13,40

Procesmbajtës,

Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**

